

Ikonostasi i kishës së Shën Nikollës, vepra e gdhendur në dru nga mjeshtra artizanë në shek.XIX



Një prej objekteve më interesante të ekspozuara në muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar në Korçë është Ikonostasi i kishës së Shën Nikollës nga Rehova e Ersekës.

Ikonostasi i takon shek. të XIX dhe ruhet në gjendje shumë të mirë në njërin prej ambienteve më impresionuese të Muzeut, në dhomën e kuqe.

Gdhendja e ikonostasit është realizuar nga mjeshtra artizanë, të cilët mbeten anonimë. Në ikonostas mbizotërojnë motive floreale, të cilat janë jo vetëm të gdhendura në relief, por edhe të pikturuara.

Muzeu i Artit Mesjetar bën të ditur se “ikonat e vendosura në të, jo të gjitha i përkasin këtij Ikonostasi, por arrijnë të qëndrojnë në harmoni me njëra-tjetrën dhe të përcjellin po të njëjtën magji, si shekuj më parë”.

I konsideruar si një nga qendrat muzeore më të rëndësishme të Shqipërisë, ai hapi

dyert në vitin 1980 dhe iu nënshtrua restaurimit në vitin 2016, ku u vendos në ndërtesën e re bashkëkohore.

Me një fond prej 8000 ikonash dhe objekteve të karakterit religjioz, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, falë ndërtimit bashkëkohor, është një ndër destinacionet më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore.

I pozicionuar përgjatë bulevardit “Fan Noli” në Korçë, ky muze është jo vetëm një ekspozitë vizive vlerash, por edhe një institucion unikal në rajon.

— ata.gov.al